




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.03.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 01.03.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 152, të datës 15.02.2021, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç), nenin 54 të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2020

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2020, në shumën prej 157,692.45€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave dhe mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve nëpër kodet e programeve, nënprogrameve si në vijim:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për paga dhe shtesa - 11, në programin Shërbimet e Zjarrëfikësve 18210, për pagesën e rritjes së koeficientëve sipas memorandumit për zjarrëfikës;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej 100,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime -13, programi Administrata e Shëndetësisë 73011, me këtë shpërndarje.
 - 1.2.1 Mjetet financiare të propozuara për shpenzim në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 destinohen, shuma prej: 60,000.00€ për harmonizimin e përfaqësuesve të pagave të punëtorëve shëndetësorë - mjekëve, infermjerëve dhe stafit mbështetës të Karitasit, shuma prej: 20,000.00€ për menaxhimin e nevojave të krijuara me situatën pandemike Covid - 19 dhe shuma prej: 20,000.00€ për blerjen dhe furnizimin me shtretër për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë.
 - 1.3 Mjetet financiare në shumë prej 47,692.45€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi Administrata e Arsimit 92010, për zëvendësime në personelin arsimorë si dhe nevojave tjera për mbarëvajtjen e procesit arsimorë.
2. Mjetet financiare nga paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, pika 1.2.1 dhe nënparagrafi 1.3, të këtij vendimi lejohen për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen e obligimeve nga memorandum për rritje të koeficientëve për zjarrëfikës, për pagesën e mjekëve, infermjerëve dhe personelit mbështetës, menaxhimin e nevojave të krijuara me situatën pandemike Covid -19, për blerjen dhe furnizimin me shtretër

në shëndetësi dhe për pagesën e zëvendësimeve në personelin arsimorë si dhe nevojave tjera për mbarëvajtjen e procesit arsimorë.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi, 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**






REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.03.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 01.03.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 153, të datës 15.02.2021, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 8 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 27/2008), nenin 27 të Ligjit 03/L-048, për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (ç) dhe nenin 54 të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2020 në vitin fiskal 2021


1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2020, në vitin fiskal 2021 në shumë të përgjithshme prej 3,023,613.65€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 153, të datës 15.02.2021.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 10,000.00€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 147,692.45€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike shpenzime për komunal shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 3,118.94€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 44,239.21€;
 - 2.5 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 2,818,563.05€.
3. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një dhe dy të vendimit është e detajizuar dhe e përshkruar, për secilin shpenzim në dokumentin financiar që është pjesë e këtij vendimi.

4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Financa dhe Buxhet.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha



Komuna: FUSHË KOSOVËS						
Nën/Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkcional	Fondi Burimor	Kategoria ekonomike	Pershkrimi i nënzerit	BARTJA 2020
SHËRBIMET E ZJARRFIKËSVE - FUSHË KOSOVË	18210	320	22	11	PAGA DHE SHTESA	10,000.00
Paga dhe meditje						10,000.00
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË - SHENDETESI	73011	760	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	100,000.00
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË - ARSIM	92010	980	22	13	MALLRA DHE SHËRBIME	47,692.45
Mallera dhe sherbime						147,692.45
INFRASTRUKTURA PUBLIKE - FUSHË KOSOVË	18162	451	22	14	SHPENZIME KOMUNALE	3,118.94
Komunali						3,118.94
ZHVILLIMI RURAL DHE INSPEKSIONI I BUJQËSISË - FUSHË KOSOVË	47042	421	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	43,700.00
ADMINISTRATA - FUSHË KOSOVË-SHËNDETËSI	73011	760	22	20	SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	539.21
Subvencione						44,239.21
			22	30		2,818,563.05
Kapitale						2,818,563.05
TOTALI : FUSHË KOSOVË						3,023,613.65

Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2020 në vitin 2021	
--	--

Komuna: FUSHË KOSOVË

Programi	Kodi i nën-programit	Kodi Funkso nal	Fondi Burimo r	Kategor ia ekonomi ke	Kodi i projektit	Pershkrimi i nënzerit	BARTJA 2020
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	46263	Blerja e Kontinjereve	10,000.00
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	49169	Blerja e Veturave	11,112.00
Administrata - Fushe Kosove	16302	133	22	30	49315	Ditxhitalizimi I salles se Kuvendit Komunal ne Fushe Kosove	10,000.00
Buxheti - Fushe Kosove	17502	112	22	30	44683	Pagesa per Vendime Gjyqesore Kompenz.per palet e demtuara	175,022.82
Buxheti - Fushe Kosove	17502	112	22	30	44684	Bashkfinancim I Projekteve	5,975.13
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	43045	Ndertimi I parqeve,trotuareve kendi lojerave	15,959.35
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44693	Ndertimi I rrugeve me zhavor	106,120.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44697	Vendosja e Ndrigimit publik dhe mirembajtja e tyre	21,186.56
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44698	Rastet Emergjente	183,764.15
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44699	Rregullimi I parkut ne pisha te sllatines se vogel	119,496.46
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	44701	Shenj,Horiz/Verti,RR.Pastrimi I Sezonit Dimeror dhe veror	175,628.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	49359	Ndertimi I rrethojes ne rrugen Nenë Tereza ne Fushe Kosove	100,000.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	49363	Rregullimi I sheshit ne Lagjen Dardania	200,000.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	49420	Ndertimi I urave,shtratit te lumenjeve,liqeneve ,perroskave etj	100,000.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	50006	Ndertimi I parqeve,trotuareve kendi lojerave dhe mbjellja e pemeve dekorati	179,853.00
Infrastruktura Publike - Fushe Kosove	18162	451	22	30	50143	Mirembajtja e investimeve	75,347.24
Zhvillimi Rural dhe Inspekcion I Bujqesise-Fushe Kosove	47042	421	22	30	40106	Pastrimi sanitar I pyjeve	15,000.00
Zhvillimi Rural dhe Inspekcion I Bujqesise-Fushe Kosove	47042	421	22	30	44677	Pyllezimi I siperfaqeve te zhveshura	15,000.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	49732	Ndertimi I kanalizimit dhe ujesjellesit (Fshatra,Qytet)	157,589.25
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	40113	Asfaltimi ne Sllatin e Madhe	31,731.16
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44776	Asfaltimi ne Fushe Kosove	46,927.80
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44780	Asfaltimi ne Grabove	8,402.20
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44786	Asfaltimi ne Sllatin e vogel	5,278.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44788	Asfaltimi ne Miradi te Eperme	51,973.44
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44790	Asfaltimi ne Nakarade	7,438.60
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44791	Asfaltimi ne Harilaq	3,067.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44793	Asfaltimi ne Henc	6,889.40
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44797	Asfaltimi ne Miradi te Poshtme	47,430.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	44801	Hartimi I planeve dhe projekteve ideore	170,000.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	46251	Asfaltimi Pomezotin	1,252.00
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	47628	Asfaltimi ne Vragoli	6,326.30
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	89195	Asfaltimi ne Bardh te madh	17,215.50
Planifikimi Hapesinor dhe rregullativ - Fushe Kosove	66015	620	22	30	89203	Asfaltimi ne Lismir	4,000.60
Administrata Shendetesi - Fushe Kosove	73011	760	22	30	44837	Nderti Shtepive per raste sociale	233,024.44
Administrata Shendetesi - Fushe Kosove	73011	760	22	30	49134	Renovimi I shtepive per raste Sociale	32,548.92
Administrata Shendetesi - Fushe Kosove	73011	760	22	30	44984	Ndertimi I AMP-se ne Fushe Kosove	53,498.00
Administrata Shendetesi - Fushe Kosove	73011	760	22	30	47636	Mirembajtja e objekteve shendetesore	20,784.29
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	49792	Ndertimi I dy shtatoreve'Ibrahim Rugova dhe Adem Jashari'	180,000.00
Sherbimet Kulturore - Fushe Kosove	85002	820	22	30	48721	Ndertimi I fushave te sportit dhe salles	112,745.44
Administrata Arsim - Fushe Kosove	92010	980	22	30	44916	Mirembajtje e objekteve Shkollore	1,201.00
Administrata Arsim - Fushe Kosove	92010	980	22	30	49133	Blerja e Inventarit per Shkolla	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJO
Nr./an/Bc.st. <u>29</u>
Data/Datum <u>05.03.2021</u>
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 03.03.2021

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 01.03.2021, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 4, nenin 5, nenin 10, nenin 11, nenin 12, të Udhëzimit Administrativ për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrënim dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës Nr. 02/2018, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), nenin 54, shkronja (dh, f) të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë për vitin 2021

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2021 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.55€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 2.10€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënit në shumë prej 0.95€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 4.84€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2021, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr. 4639-2/20, të datës 24.11.2019.
3. Objektet publike institucionale që financohen nga institucionet shtetërore lirohen nga taksat për leje ndërtimore.

4. Llogaritja e taksave administrative për leje ndërtimore të kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë, leje të rrënimit dhe tarifa për rregullimin e densitetit në infrastrukturë, bëhet duke u mbështetur në pikën një të vendimit.
5. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera, për zbatimin e vendimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban.
6. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

